



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Zyra e Kryeministrit - Ured Premijera - Office of the Prime Minister

---

*Agjencia e Statistikave të Kosovës - Agencija za Statistiku Kosova - Kosovo Agency of Statistics*

---

Ne bazë të Kreut III neni 11 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civilë të Kosovës dhe neni 22 paragrafi 3 të Rregullores Nr. 02/2010 Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, *Agjencia e Statistikave të Kosovës* shpallë:

**NJOFTIM**

**Vazhdohet edhe për shtatë (7) ditë kalendarik afati i konkursit, i shpallur me dt. 19.07.2017 në gazetën ditore Epoka e Re në Ueb-faqen e Agjencisë të Statistikave të Kosovës për pozitën:**

***Te gjithë kandidatet të cilët kanë aplikuar në afat dhe procedurë të rregullt për këtë pozitë nuk kanë nevojë për ri-aplikim.***

**1. Departamenti i Metodologjisë dhe TI-së një (1) pozitë të karrierës:**

**Titulli: Një (1) Zyrtar i bazës së të dhënave**

**Numri i referencës : ASK-DMTI-se -002**

**Koeficienti : 6**

**Detyrat dhe përgjegjësit :**

- Bënë përfshirjen e të gjitha hulumtimeve, anketave dhe shënimeve të tjera të ndryshme statistikore të mbledhura nga terreni,
- Bënë zbatimin konciz të programeve të implementuara për përfshirjen e hulumtimeve përkatëse,
- Në bashkëpunim me udhëheqësin bën planin e punës një vjeçare për përfshirjen e aktiviteteve dhe materialeve tjera hulumtuese,
- Raporton në baza ditore, javore dhe sipas nevojës edhe për afate më të gjata për dinamikën e kryerjes së punëve;
- Azhurnimi i data bazës me të dhënat nga terreni,
- Punët tjera shtese të cilat i kërkohen nga mbikëqyrësi.
- Kryen edhe punë tjera varësisht prej kërkesave të Udhëheqësit divizionit.

**Kualifikimi :** Diploma universitare, Fakulteti nga fushat ekonomike, shoqërore, apo juridike  
**Përvoja e punës:** Diplomë universitare pa përvojë ose shkollë e larte dhe së paku dy (2) vite përvojë pune  
**Kompetenca dhe aftësitë:** Njohja e kompjuterit (Word ,Excel,Outlook) ,  
-Bashkëpunimi ne mënyrë ekipore e nevojshme,  
-Të ketë aftësi të ruajtjes së konfidencialitetit të të dhënave individuale statistikore.  
-Të ketë shkathtësi te dëshmuara dhe efektive te komunikimit ,  
-Aftesi të njohjes së Gjuha Angleze

**Procedura e konkurimit:**

Në Shërbimin Civilë kanë të drejtë të punësohen shtetasit e Republikës se Kosovës të moshës madhore ,të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, përgatitje të nevojshme arsimore dhe aftësi profesionale për zbatimin funksionit administrativ dhe të cilët kanë aftësi fizike që kërkohen për pozitën përkatëse.

**Aktet ligjore dhe nënligjore që e rregullojnë rekrutimin:**

Përzgjedhja e Shërbyesve Civilë bëhet në pajtim me Ligjin –Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civilë te Republikës se Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e rekrutimit ne Shërbimin Civilë.

**Kohëzgjatja e emërimit:** Sipas Ligjit të Shërbimit Civil të Republikës së Kosovës , në të cilën është përfshirë periudha e punës provuese prej një (1) viti.

**Konkursi është i hapur 7 dite kalendarik nga dita e publikimit në mjetet e informimit publik.**

**Marrja dhe dorëzimi i aplikacioneve:**

Aplikacionet merren dhe dorëzohen në Agjencionin e Statistikave te Kosovës , Rr, ”Zenel Salihu” nr.4 Prishtinë. Aplikacionit i bashkëngjiten kopjet e dokumentacionit mbi kualifikimin, dëshmi mbi përvojën e punës , vertetimin nga Gjykata që personi nuk është nënë hetime dhe dokumentacionet e tjera të nevojshme , që kërkohen për vendin e punës për të cilin konkurrioni. Kërkesat e dërguara pas datës së fundit nuk do të pranohen. Kërkesat e pakompletuara do të refuzohen.

Për shkak të numrit të madh të kërkesave të pranuar , vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen.

Kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do ti nënshtrohen testimit me shkrim dhe intervistimit.

Për informata të hollësishme, mund të kontaktoni me zyrën e personelit , në tel: 038- 20031149 , prej orës 08:00 – 16: 00.

*“Shërbimi Civilë i Kosovës ofron mundësi të barabarta te punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë.*

*“Komuniteti jo - shumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në organet e shërbimit civil të administratës publike qendrore dhe lokale, siç specifikohet në Nenin11, paragrafin 3 të Ligjit Nr. 03/L-149 mbi Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës”.*

